



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, 8 korrik 2013
Nr. Ref.:RK446/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 09/12

Parashtruesi

Lavdërije Telaku

**Kërkesë për vlerësimin e Kushtetutshmërisë së Aktvendimit Rev.I.
nr.481/2009 të 18 tetorit 2011 dhe
Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës Ac.nr 79/2011
të 24 nëntorit 2011**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përberë nga:

Enver Hasani, Kryetar,
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi gjyqtare

Parashtruesja e Kërkesës

1. Parashtruese e kërkesës është znj. Lavdërie Telaku (në tekstin e mëtejme: Parashtruesja), me vendbanim të përhershëm në Prizren.

Vendimi gjyqësor i kontestuar

2. Vendimet e kontestuar janë është: Aktvendimi Rev.I. nr. 481/2009 i 18 tetorit 2011 i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), dhe Aktgjykimi Ac.nr. 79/2011 i 24 nëntorit 2011 i Gjykatës Supreme.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës së parashtruar është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme Rev.I. nr. 481/2009 të 18 tetorit 2011 dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Ac.nr. 79/2011 të 24 tetorit 2011, që kanë të bëjë me kontest familjar. Parashtruesja e kërkesës pretendon se pasojat e këtyre vendimeve shkelin të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), pa përmendur specifikisht cilat të drejta.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 47 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës i 16 dhjetorit 2008, i hyrë në fuqi më 15 janar 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe Rregulli 28 i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

5. Më 31 janar 2012, Gjykata Kushtuese pranoi kërkesën parashtruar nga parashtruesja dhe e regjistroi atë me nr. KI 09/12.
6. Me 1 shkurt 2012, parashtruesja është njoftuar për regjistrimin e kërkesë dhe i është kërkuar dokumentacion shtesë për plotësimin e kërkesës së parashtruar.
7. Më 21 shkurt 2012, Kryetari, me vendimin GJR. 09/12 caktoi Gjyqtar raportues, gjyqtarin Alty Suroy. Të njëjtën ditë, Kryetari, me vendimin KSH. 09/12, caktoi anëtarët e Kolegjit shqyrtues në përbërje të gjyqtareve: Ivan Čukalović (kryesues), Gjyljeta Mushkolaj (anëtare) dhe Iliriana Isalami (anëtare).
8. Më 2 korrik 2012, Kryetari, me vendimin GJR. 09/12 riemëroj Kolegjin e ri Shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Ivan Čukalović (kryesues), Kadri Kryeziu, caktohet në vend të Gjyqtarës Gjyljeta Mushkolaj, meqë asaj mandati si gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese i përfundoj me 26 qershor 2012, dhe Arta Rama-Hajrizi, u caktua në vend të gjyqtarës Iliriana Islami, se cilës po ashtu i kishte përfunduar mandati me 26 qershor 2012.

9. Me 5 shtator 2012, parashtrueses sërish i është kërkuar dokumentacion shtesë, përkatësisht disa vendime të gjykatave të rregullta, lidhur me rastin e saj.
10. Më 14 shtator 2012, parashtruesja dorëzoi dokumentacionin e kërkuar nga Gjykata.
11. Më 25 qershor 2013, Kolegji Shqyrtues pasi shqyrtoi raportin e Gjyqtarit Raportues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Parashtruesja e kërkesës kishte lidhur martesë më 7 shkurt 1992 me z. A.T. nga Prizreni, nga kjo lidhje bashkëshortore, bashkëshortët kishin lindur tre fëmijë.
13. Për shkak të përkesqësimit të raporteve familjare, në vitin 2004 filluan të jetojnë ndarazi.
14. Në një datë të paspecifikuar ish bashkëshorti i parashtrueses, A.T. ushtroi padi për shkurorzim në Gjykatën e Qarkut në Prizren

Procedura lidhur me Vendimin e Gjykatës Supreme Rev. I.nr.481/20099, në të cilën parashtruesja paraqitet si paditëse

15. Me 15 mars 2007 Gjykata Komunale në Prizren nxorri Aktgjykimin C.nr.21/2007, me të cilin aprovoi kërkesën e E.T., L.T., dhe F.T. që janë të përfaqësuar nga parashtruesja si përfaqësues ligjor.
16. Në pjesën operative të vendimit Gjykata Komunale aprovoi kërkesën e aplikueses dhe urdhëroi A.T. " që në emër të alimentacionit të paguajë nga 150 € në muaj për secilin fëmijë ose në total 450 € në muaj, deri më datën 5 të çdo muaji duke filluar nga 19.01.2007" [...] "deri sa kushtet ligjore të jenë në fuqi ose deri sa nuk ndryshohet ky aktgjykim"
17. Në një datë të paspecifikuar A.T. ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut kundër Aktgjykimit C.nr.21/2007.
18. Më 17 qershor 2007, Gjykata e Qarkut në Prizren nxorri Aktgjykimin Ac.nr.241/2007, pjesërisht aprovoi ankesën e A.T. dhe ndryshoi Aktgjykimin C.nr.21/2001 të Gjykatës Komunale në Prizren
19. Në pjesën operative të Aktgjykimit, Gjykata e Qarkut theksoi se "A.T. nga Prizreni obligohet të kontribuojë në mbajtjen e fëmijëve të mitur..." [...] "në emër të alimentacionit të paguajë 80 € për secilin fëmijë apo në total 240 € në muaj, deri më datën 5 të muaji, duke filluar nga data kur është ushtruar padia deri sa kushtet ligjore të jenë në fuqi ose deri sa nuk ndryshohet ky aktgjykim"
20. Më 30 janar 2008 parashtruesja parashtroi në Gjykatën Komunale në Prizren kërkesë për mbrojtje emergjente duke kërkuar që kjo gjykatë të "të urdhërojë palën përgjegjëse A.T. nga Prizreni të paguajë qeranë mujore pre 100 € për parashtruesen"

21. Më 30 janar 2008, Gjykata Komunale në Prizren nxorri Aktvendimin C.nr.865/07, duke aprovuar kërkesën e parashtrueses dhe lëshoi urdhër për mbrojtje emergjente për palën e mbrojtur.
22. Në pjesën operative të Aktvendimit Gjykata Komunale *“urdhëron të paditurin A.T. të paguajë qeranë mujore në një shumë prej 100 € palës së mbrojtur, duke filluar nga 12 dhjetori 2005...”* [...] *“ urdhëri për mbrojtje emergjentë hyn në fuqi menjëherë dhe ankesa kunder tij nuk e pezullon ekzekutimin”*
23. Më 27 mars 2008, A.T. ushtron kundërshtim kundër vendimit për ekzekutimin e Aktvendimit C.nr.865/07.
24. Më 19 maj 2008, Gjykata Komunalë nxorri vendimin E.nr.95/08, duke refuzuar kundërshtimin e A.T. si të pabazuar.
25. Më 1 dhjetor 2008, duke vendosur në ankesën e të paditurit A.T. që ishte ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Komunalë në Prizren C.nr.865/07 të 30 janarit 2008, Gjykata e Qarkut nxorri Aktvendimin Ac.nr.105/08 duke anuluar vendimin e Gjykatë Komunale dhe ktheu lëndën gjykatës së shkallës së parë për përsëritje të procedurës dhe rigjykim.
26. Në arsyetimin e Aktvendimit Gjykata e Qarkut theksoi se *“Gjykata e Qarkut vërtetoi se gjendja faktuale nuk është vlerësuar drejte dhe plotësisht, që ka shkaktuar zbatim të gabueshëm të të drejtës materiale.”*
27. Më 19 maj 2009, Gjykata Komunale në Prizren në një procedurë të përsëritur nxorri Aktvendimin C.nr.874/2008, duke refuzuar kërkesën parashtrueses për mbrojtje emergjente. Në të njëjtën kohë Gjykata Komunale refuzoi kërkesën e parashtrueses të përdorë për banim një pjesë të shtëpisë ku kishin jetuar më parë, sa ishin të martuar.
28. Në arsyetimin e Aktvendimit, Gjykata Komunale theksoi se *“Gjykata e shkallës së parë refuzon kërkesën e palës së mbrojtur për të lshuar urdhër për mbrojtje emergjente, sepse Gjykata e Qarkut në Prizren më 15 qershor 2007 ka nxjerrë vendimin Ac.nr.541/2007 që e obligon A.T. të paguajë alimentacionin prej 80 € për secilin fëmijë”* [...] *“...bazuar në vlerësimin e saj gjykata nuk gjen ndonjë arsye për të lëshuar urdhër për mbrojtje emergjente me të cilin do të detyronte të paditurin të paguajë qerane mujore...”*
29. Në një datë të paspecifikuar parashtruesja ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prizren kundër Aktvendimit C.nr. 874 të Gjykatës Komunale në Prizren për shkelje të pretenduara të dispozitave të procedurës civile.
30. Më 2 shtator 2009, Gjykata e Qarkut në Prizren nxorri Aktvendimin Ac.nr.323/2009, duke refuzuar ankesën e parashtrueses si të pabazuar dhe konfirmoi Aktvendimin C.nr.874/2008 të Gjykatës Komunale në Prizren.
31. Në Aktvendimin e saj, Gjykata e Qarkut sqaroi se nuk gjeti që gjatë procurave kishte ndonjë shkelje të procedurës civile, edhe pse në ankesën e saj parashtruesja nuk kishte specifikuar dispozitat që pretendonte se janë shkelur.

32. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesja ushtroi ankesë në Gjykatën Supreme për revizion të Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut Ac.nr.323/2009.
33. Më 18 tetor 2011, Gjykata Supreme nxorri Aktvendimin Rev. I. Nr. 848/2009, duke refuzuar kërkesën e parashtrueses si të pabazuar.
34. Ne arsyetimin e Aktvendimit të saj, Gjykata Supreme theksoi se :

“Gjykata e shkallës së parë, pas administrimit të nevojshme të provave dhe dëgjimit të përfaqësuesit të Qendrës për Punë Sociale në Prizren, gjeti se veprimet e te paditurit nuk përbënin dhunë në familje siç është paraparë më nënin 2.1.j të Rregullores së UNMIK-ut 2003/12”

[...]

“Gjykata e shkallës së dytë në procedurë të ankesës ka konfirmuar plotësisht gjendjen faktike dhe qendrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, duke refuzuar si të pabazuar ankesën e palës së mbrojtur dhe konfirmoi vendimin e gjykatës së shkallës së parë.”

Procedura lidhur me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Ac. no. 79/2011, në të cilën parashtruesja paraqitet si e paditur

35. Më 9 qershor 2011, Gjykata e Qarkut në Prizren nxorri Aktvendimin C.nr.45/2011, i cili e përfundoi martesën e parashtrueses me A.T. me shkurorëzim.
36. Në Aktgjykimin e saj, Gjykata e Qarkut refuzoi kërkesën e parashtrueses për alimentacion prej 250 €, derisa kërkesa për të jetuar në shtëpinë e përbashkët të A.T. apo të urdhërojë atë të paguajë qiranë mujore është shpallur e pabazuar.
37. Si bazë ligjore të vendimit të saj, Gjykata Supreme theksoi se *“kërkesa e të paditurës refuzohet, pasi që paditësi nuk ka shtëpi në emër të tij”* [...] *“dhe duke marrë para sysh që ai nuk është i punësuar dhe aktualisht nuk realizon të ardhur nga ndonjë burim tjetër, nuk është në gjendje ta paguajë qeranë”*
38. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesja ushtroi ankesë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit C.nr.45/2011 të Gjykatës së Qarkut në Prizren.
39. Më 24 nëntor 2011, Gjykata Supreme nxorri Aktgjykimin Ac.nr.79/2011, që e refuzoi ankesën e parashtrueses si të pabazuar dhe vërtetoi Aktgjykimin C.nr.45/2011 të Gjykatës së Qarkut në Prizren.
40. Në arsyetimin e Aktgjykimit të saj, Gjykata Supreme theksoi *“Gjykata e shkallës së parë bazuar në gjendjen faktike ka zbatuar drejtë dhe në mënyrë të plotë të drejtën materiale, kur refuzoi kërkesën e të paditurës për banim në shtëpinë e paditësit apo që ai ti paguajë qeranë.”* [...] *“Gjykata e Qarkut ka shqyrtuar të gjitha faktet dhe ka gjetur se paditësi nuk mund të paguajë alimentacionin dhe banimin, pasi që nuk është i punësuar dhe nuk realizon të ardhura nga burime tjera...”*

Pretendimet e parashtrueses

41. Parashtruesja e kërkesës, pretendon janë shkelur të drejtat e saj të garantuara me Kushtetutë. Sidoqoftë, ajo nuk specifikon asnjë dispozitë kushtetuese.
42. Më tej, parashtruesja pohon se gjatë procedurave në gjykatat e rregullta janë bërë shkelje të dispozitave të Ligjit të Familjes që kanë të bëjnë me sigurimin e strehimit.
43. Parashtruesja gjithashtu thekson e ish bashkëshorti i saj A.T. e ka dëbuar nga shtëpia dhe më vonë e ka penguar atë të kthehet.
44. Përfundimisht, parashtruesja e kërkesës kërkoi nga Gjykata Kushtetuese:

“të anulohet vendimet e kontestuara të gjykatave të rregullta dhe ti pranojë kërkesëpaditë në paditë e ushtruara”

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

45. Gjykata thekson se , në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtrueses, duhet që së pari të vlerësojë nëse parashtruesja e kërkesës i ka plotësuar kriteret procedurale për pranueshmëri të parapara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje në Ligj dhe Rregulloren e punës së Gjykatës.
46. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 (1) dhe nenit 113(7) të Kushtetutës që përcakton se:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar. (...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

dhe nenit 48 të Ligjit, që thekson:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

47. Gjykata vëren se parashtruesja në kërkesën e saj ka theksuar se aktgjykimet dhe aktvendimet e gjykatave të rregullta kanë shkelur Ligjin e Familjes, respektivisht dispozitat që rregullojnë çështjen e strehimit. Megjithatë, parashtruesja nuk ka specifikuar se cilat dispozita të Kushtetutës apo Ligjit janë shkelur.

48. Gjykata Kushtetuese përsërit që nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e apelit, apo gjykatë e shkallës së katërt lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës, nr. 30544/96, § 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] e 1999-I).
49. Gjykata Kushtetuese mundet vetëm të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë, dhe nëse procedurat në përgjithësi të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë saqë parashtuesi i kësaj kërkesë të ketë pasur gjykim të drejtë (shih ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa nr. 13071/87 e miratuar më 10 korrik 1991).
50. Megjithatë, pas shqyrtimit të dokumenteve të doëzuara nga parashtuesja, Gjykata Kushtetuese nuk ka gjetur asnjë indikacion që procedurat para Gjykatës Supreme ishin të padrejta apo të prekura nga arbitrariteti (shih Vanek kundër Republikës Sllovaqe , Vendim mbi Pranueshmërinë GjEDNJ-së ECtHR në rastin 53363/99 të 31 Majit 2005).
51. Prandaj, parashtuesja e kërkesës ka dështuar të tregosë se pse dhe si gjykatat e rregullta i kanë shkelur të drejtat e saj të garantuara me Kushtetutë, Gjykata thekson se Aktvendimin i Gjykatës Supreme Rev. I. Nr. 481/2009 i datës 18 tetor 2011 dhe Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Ac. nr. 79/2011 i datës 24 nëntor 2011 ishin të argumentuara dhe të arsyetuara mirë.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 dhe 48 të Ligjit, rregullin 36.2 (b) dhe (d) të Rregullores së punës, më 8 korrik 2013, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. T'UA KOMUNIKOJË vendimin palëve;
- III. TA PUBLIKOJË vendimin në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Altay Suroy



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani